



ËNDËRRIME

Naim Frashëri

PAK FJALË LEXUESVE

Përmbledhja e poezive lirike romantike të poetit tonë kombëtar, Naim Frashëri, shkruar në persishte dhe botuar në Stamboll më 1884, nën titullin e përbashkët *Tehajjul*, përbën fazën e parë të krijimtarisë së tij. Megjithatë ajo nuk pa dritën e botimit në gjuhën shqipe, për shkak se në atë kohë poeti ynë, i ndodhur përballë ngajrjeve të rëndësishme politike, që po zhvilloheshin në dëm të kombit tonë, u hodh në sferën e gjerë të veprimtarisë për përhapjen e arsimit dhe kulturës, kombëtare, si detyrë urgjente që shtronte në atë kohë lëvizja për forcimin e plotë të vetëdijes politike shqiptare në funksion të luftës për çlirimin dhe mbrojtjen e atdheut. Për këtë qëllim patriotik ai zhvilloi veprimtari të madhe në të përmuajshmen “Drita” - “Dituria” në Stamboll (10 gusht 1884-20 korrik 1885) në bashkë-veprim me Sami Frashërin, Jani Vreton dhe Pandeli Sotirin, ky i fundit kryeredaktor i saj, ku, siç dihet, Naimi filloi të shquhej si poet i madh kombëtar.

Në këto rrethana historike përmbledhja poetike *Tehajjul*, pas një kohe të gjatë e qarkulluar në Stamboll dhe sidomos në Persi, në vitin 1971 ra në dorën e poetit Vexhi Buharaja në Tiranë, njohës i pashoq i gjuhës persiane dhe shqipëruës mjeshtëror, i cili e bëri atë të flasë në gjuhën elegante shqipe me emrin *Ëndërrime*.

Përmbledhja poetike *Ëndërrime* përbëhet prej 26 poezish, shkruar gjatë kohës së qëndrimit të Naimit në Berat (viti 1873) nëpunës në Zyrën e tatimit të të dhjetave në Sarde (në vitet 1874-1877) nëpunës në Zyrën e doganës në Sarandë e më pas në Stamboll, ku u vendos përfundimisht me familje, me punë kryetar i Komisionit të kontrollit të botimeve pranë Ministrisë së Arsimit Turk, ku siç dihet, ndihmoi shumë për dhenien e lejeve të qarkullimit të botimeve shqipe që shtypeshin në Stamboll, Bukuresht etj. në qarqe atdhetare kulturore shqiptare.

Gjatë viteve 1873-1883, kur mbyllet ky cikël i poezive, në imazhin e frymëzimeve poetike meditative në objekte të veçanta frymëzimi mbi natyrën, në shpjegimin e fenomeneve botëkuptimore dualiste fetare e filozofike, janë të kristalizuara në gjerdanin e poezisë së tij të bukur përshkruar në mendime të thella si dijetar i vërtetë. Kjo shihet qartë në poezinë *Qielli*, shkruar në vitin 1875 ku hapet vëllimthi, pa ndjekur kriterin kronologjik kohor, kur duhej të vihej më përpara vjersha *Gjuha e zemrës* e botuar në vitin 1874:

“Një shkëlqim që s’ka fillim e s’ka mbarim”, - shkruan poeti në vjershën *Qielli* - është “Kuptim, fuqi, pasqyrë e Zotit tim”. Duke mos arritur ta shpjegojë shkencërisht këtë fenomen, poeti pyet:

“Ç’është, ç’është kjo e paana Gjithësi?
Dhe ky rregull dhe ky libër që sheh ti?
Kjo e kaltër hapësirë e paanë?
Këto drita që kufi e numër s’kanë?
Këta yje trupergjendë e faqeartë?
Kjo natyrë dhe ky det, burim i jetës?
Këto ligje, këto pamje të së fshehtës?”

Por në fund poeti, duke mos e dhënë dot kuptimin shkencor, ose edhe duke u rezervuar të japë mendime për shkak të keqkuptimeve që mund të krijoheshin, arrin në përfundimin e tij për këtë fenomen shkencor ende të pazgjidhur, se:

“Mençuri e Zotit shfaqet në çdo vend

Plotfuqinë e tij shikojmë në çdo send”.

Megjithatë, sipas Naimit, rrugëzgjdhja shkencore e kësaj fshehtësie shprehur në vjershën *Gjuha e zembrës*, botuar në vitin 1874 në këtë përmbledhje, u takon rrugënjuhësve të dijes, zbulimtarëve, pra, këtë enigmë, mendon ai, duhet ta shpjegojnë dijetarët e ardhshëm. Vjershat *Qielli dhe Gjuha e zembrës* dëshmojnë për rrugët kërkimore të dijes së Naimit në atë kohë. Ato dëshmojnë se kohën e lirë Naimi në Berat dhe në Sarandë e kalonte jo “duke luajtur domino apo tavllën”, apo “duke u marrë me gjueti”, siç pretendojnë disa studjues. Por ai, pas punës dinte si të gjente kohën për të soditur e për t’u çlodhur në vende pitoreske të natyrës së bukur jugore shqiptare, e si të zhytej në botën e studimeve për zgjerimin e njohurive shkencore e letrare dhe që shumë shpejt ai do të njihet si personalitet në botën zyrtare perandorake osmane dhe me pas si poet i madh në dobi të kombit. Pra, vepërza *Ëndërrime* e shkruar në atë kohë, vlerëson kuadrin e lartë të poetit tonë në vijën e ecurisë së tij. Ende më i qartë del në pah formimi i tij si dijetar dhe si poet në poezinë *Toka dhe njeriu*, kur fuqia krijuese e talentit të tij të veçantë shkrihet në brendinë e thellë të mendimeve që zotëronte ai si poet dhe iluminist, që dijen dhe artin e të shkruarit i vinte në shërbim të kombit. Dhe ja, imazhi i poetit dhe dijetarit Naim Frashëri në *Toka dhe njeriu*, ku ai shkruan:

“Këjo Tokë, që aq baltë ka rrufitur,
Një yll është nga të qiellit yj të ndritur.
Nëpër qiej udhëton ajo aq mirë,
Po si zogu fluturon në hapësirë,
Ç’është veç një copëz hënë-e fenerit.
Diellin zjarrpërhapës ka si nënë
Dhe si bijë këmbëlehtn’e bukur Hënë.”

Siç shkruan më pas Naimi, toka ka si motër edhe planetë të tjera, plot me zjarrn’e Diellit mbushur e ka gjinë, kaq të mira nxjerr nga zemra mbi siprinë. Dhe se nga ai zjarr i saj kanë dalë bimë e xehe që nuk numërohen dot, kaq lule e drunjë e pemë plot. Por krahas tyre, shton Naimi, bashkë me llojet e shumta të frymorëve të ndryshëm doli edhe njeriu. Prandaj:

“Pranë Tokës rri gëzohu o njeri!
Se kjo Tokë u bë, pra për ty shtëpi
Meqë u vure si mëkëmbës o te ky Dhe
Pra, këtu kërkë edhe gaz edhe hare.

Elemente të formimit të personalitetit me njohuri të gjerë e me forcë krijuese poetike shihen kudo në poezinë e Naimit mbi natyrën, përfshirë në këtë përmbledhje me vlerë njohëse.

“Dita jote frymëzim për vjershëtorët - shkruan ai në poezinë *Hëna* - Faqja jote udhëheqës për shenjtorët

Rrotull tokës ardhur ke që prej fillimit.
Prandaj parë ke të fshehtë e njerëzimit.
Sa përleshje, moj, në Tokë ti ke parë?
Sa trazime, sa mjerime, sa llahtarë?
Ti ke parë se ç’ka hequr njerëzimi
ke dëgjuar fjalë e klithma dëshpërimi.

Sa Sokratë na ke parë të helmuar?
Sa Jusuf, pre për ujqër të tërbuar?
E sa kombe moj ke parë ti në botë,
Sa u zhdukën krejt pa lënë shenj'ë skotë?
Sa Solonë, sa Platonë ti ke parë?
Sa Karunë, sa Timurë gjakatarë?
Sa Daranj e Aleksandër emërndjerë?
Dhe pastaj, moj sa Ruso e sa Volterë?

Pra, Hëna, kjo bukuroshe frymëzimi për poetët, nga poeti ynë bëhet objekt frymëzimi madhështie, si dëshmitare e ngjarjeve mbi Tokë në historinë e njerëzimit dhe e fenomeneve të natyrës në tërësi nga shekulli në shekull.

Shëtitjet buzë detit dhe buzë lumit i jepnin forcë frymëzimi poetik Naimit dhe për një çast vargjet i dilnin nga thellësia e shpirtit, kur ndalej dhe i drejtohej hapësirës qiellore, që larg e larg dukej sikur puthej me detin:

“O ti det që t’ep flladitje e gëzim - vargëzon poeti në vjershën *Në breg të detit*:

Te ti gazin më gjen zemra, shpirti im
Pika jote është mëri e ujërave
Ato Isa, kurse ti je Merjeme
Ajo që si zog mbi male ka qëndruar,
- Që më duket si fanitje-e avulluar:
Pjella jote është ujtë lart atje,
Që ta mori dielli dhe ta bëri re
Në çdo hop një ngjyrë tjetër merr ai,
Herë i bardhë, herë i kuq e herë i zi.
Zjarri i diellit e tërheq drejt lartësish,
Por shpejt koha ty ta kthen atë sërish.
Andej gumëzhim e detit valëshumë
Këtej ligjërima e të shpejtit lumë.

Natyra e gjallë dhe e bukur e Sarandës e shtang poetin, i jep gjallëri dhe frymëzim poetik. Duke hedhur vështrimin në çast me soditje, ai shkruan:

Te livadhi po kullosin bagëtia
prapa blegërim e shqerave moria,
ndërsa:
Poshtë drunjvet, përmes kopshtesh duke çarë,
Rrëshqet kroi me të qeshur, me të qarë.
Gjithë zogjtë lart në ujë vijnë-e shkojnë,
Enden, sillen rreth e rrotull e këndojnë.

Në atë kuadër të bukur të stinës pranverore të vitit 1876, sipas vitit që na e jep vjersha, në fund të saj, poeti e jep këtë panoramë tërheqëse jo statike, por në lëvizje soditëse të tij,. Duke i shqitur sytë nga deti, ai vështron lumin me valë të shpejta dhe, pasi qëndron te gumëzhima e kroit, e hedh përsëri vështrimin nga gjelbërimi i fushës ku kullosin bagëtia e sipër ku cicërojnë me këndje muzikore zogjtë në ajër që vijnë e shkojnë, enden, sillen rreth e rrotull e këndojnë.

Poezia e tij intime elegjiake shpreh dhimbje të prekshme për vdekjen e motrës, vëllezërve, bijave e mbesave. Në poezinë *Mbi trupin e bijës sime të vdekur* ai qan me vaj:

“Mjeri unë vaj moj bijë, mjeri unë!
Moj e dashur, moj e ëmbëla aq shumë.
Pa ty mbeta, pa ty mbeta moj në botë
U shkretofsh o qiell, moj zuzarja Rrotë.
Dhe d'bëhet faqja jote trandafile
Dhe cullufeza e bukur si zimbile
Re për krimbat ajo dor' ai kerçi,
Nën të ertin dhe në varrin ferr të zi”.

Është koha kur Naim Frashëri merr rrugën në det me familjen e tij në drejtim të Stambollit, me punë në postin e lartë të kryetarit të Komisionit të kontrollit të botimeve në Ministrinë e Arsimit Turk, kur, siç shkruan në vjershën *Lamtumirë*, në ato çaste të udhëtimit përmes ujërave të Detit Jon, u jep lamtumirën shokëve dhe miqve për kokë, maleve dhe fushave të blerta, burimeve, përshëndet me ndjenjë melankonie:

“Lamtumirë o qiell, diell, yj me dritë
O atdhe moj kohë, o moj nat'e ditë
Silli tokës hirin tënd o moj pranverë
Më kujto pastaj dhe mua ti një herë!”,

dhe ndërsa ai relief tokësor i bukur vjen e zbehet larg-larg, poeti tanimë mediton, mendon detyrën për të ardhmen e atdheut, për të cilin ai do të shkrijë jetën si qiri i ndezur. Edhe pse larg, në Stamboll në mes të të mirave të jetës, poeti me trup dhe me shpirt jeton në atdhe. Këtë e shohim qartë në vjershën kushtuar atdheut:

“O Atdhe më je i dashur sa më s'ka,
Më je nënë, më je motër, më je vlla.
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe.

Edhe për faktin se tek ky dhe linden, jetuan dhe vdiqen nga brezi në brez njerëzit e trungut të tij familjar.

Ty përdite të pat parë ime nënë,
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.
Numëruar ti pat lulet syri i saj,
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.

Pastaj me ndjenjë të permalluar vazhdon:
Ti ke parë gjysh-stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtrat tretur ua ke po ti.
Nga ti shpirt, o ata kurrë s'qenë ndarë.
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.
Nena ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë.
Nënë që s'ke vdekur kurrë faqehënë.

I prekur në mendime dëshpëruese se ndoshta nuk do të kthehet më, poeti shprehet me optimizëm se populli shqiptar kurrë nuk do të shuhet nga faqja e dheut. Përkundrazi, nga koha në kohë do të shtohet e do të përparojë:

Dhe pse ha, o dhé ti bijt' e tu të mjerë
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.

Prandaj poeti Naim Frashëri me forcë dhe zjarr atdhetarizmi, lutet:

Begatoje o Zot këtë vend
Epu njerëzve të tij Ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithëmonë armiqtë e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme past plot me lumturi”.

Natyra e bukur shqiptare e rrit shumë vlerën atdhetare të poetit Naim Frashëri në vepërzën *Ëndërrime*, stoli e mahnitshme ku është shkruar mendimi i tij si diejtar dhe forca krijuese si shkrimtar me penën në dorë të ngjyer në mollanin e përgjaktë të dashurisë për vendlindjen. Në veprimtarinë e tij të madhe mëmëdhetare, përmbledhjen *Ëndërrime*, të shkruar në persishte poeti Naim Frashëri nuk e la mënjanë, siç mund të jetë thënë në ndonjë rast “për t’u çliruar nga ndikimet e huaja tradicionale sunduese”. Por ai, me siguri do ta merrte këtë vepër në një kohë të qetë për ta përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo, edhe për faktin se letërsia dhe kultura persiane në Shqipëri është historikisht e përqafuar me konsideratë, sepse Persia ka nxjerrë titanë të shquar në shkallë universale si Firdeusi, Saadiu, Shiraziu, Hajami, Rumi etj., që kanë zënë vend të merituar në historinë e mendimit kulturor botëror, në të njëjtën shkallë me figurat më të ndritura që nxori bota kulturore perëndimore nga koha në kohë, ashtu si e vlerëson edhe vetë Naimi në kohën e formimit kulturor të tij në terësi. Pra, poeti Naim Frashëri e botoi këtë vepër në persishte për ta bërë të njohur në botën persiane për qëllime të mira. Megjithatë, vjershat e botuara në *Ëndërrime*, si *Toka dhe njeriu*, *Qielli*, *Dielli*, i botoi me zgjerime në revistën “Drita” - “Dituria” (Stamboll, 10 gusht 1884-20 korrik 1885), si artikuj me vlerë njohëse nën titujt përkatës *Dhetregonja*, *Kafshëtregonja*, *Njeritregonja*, etj., të cilat ai më vonë i botoi si tekste të veçanta shkollore për shkollat e para shqipe, si dhe për tërësinë popullore shqiptare në atë kohë kur shkollat shqipe ende nuk ishin hapur. Kjo dëshmon pra, se vepra në fjalë e botuar në gjuhën perse, u ruajt në kujtesën e poetit tonë Naim Frashëri gjatë veprimtarisë së tij të madhe kombëtare në vitet 80 të shekullit XIX, kur mori hov Lëvizja e organizuar kulturore e letrare për ndriçimin e atdheut drejt rrugës së luftës për pavarësinë tonë kombëtare.

Vëllimthi *Ëndërrime*, bashkë me të edhe novela *Katër stinët* përshtatur nga Naimi sipas një shkrimtari francez dhe përkthyer nga turqishtja në gjuhën shqipe po prej Vexhiut, u botuan në revistën “Studime filologjike” nr. 2, 1971. Ndërkohë ato u botuan edhe në shtypshkronjën “Rilindja”.

Me keqardhje *Ëndërrimet* u botua me gabime shtypi, si në revistën në fjalë ashtu edhe në shtypshkronjën “Rilindja”, kjo e fundit justifikohet për rrethanat e represionit të egër shovinist serb. Në vëllime të veçanta, kur përfshihen edhe *Ëndërrimet*, botuar në Tiranë, ka edhe ndërhyrje redaktoriale me shtrembërime të pavend.

Vëllimi i *Ëndërrimeve* që u jepet në dorë lexuesve të sotshëm, para se të dërgohet për shtyp është kontrolluar në mbështetje të dorëshkrimit të Vexhiut si dhe në kopjen e daktilografuar që ruhet në arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë.

Falënderoj me respekt zotin Ali Akbar Zijai, kryetar i Fondacionit kulturor “*Saadi-Shirazi*” në Tiranë, që pati mirësinë për përballimin e shpenzimeve të këtij botimi.

Ahmet Kondo
Tiranë, mars 1996

1. QIELLI¹

*Natë e qetë, hëna e bukur plot me dritë,
Fllad i ëmbël, toka hapur ka stolitë,²
Zogu i mëndjes³ po më sulet drejt nga qielli,
N'hapësirat plot me afsh e dritë dielli.
Herë bëhet shok e mik me yjet vetë.
Herë gjer te çerdhja-e Kashtës shkon përprjetë.
Nuk sheh tjetër po veç dritë bukurie,
Vetëtimë e zjarr vështrimesh Perëndie.
Një shkëlqim që s'ka fillim e s'ka mbarim...
Kupëtim, fuqi pasqyrë-e Zotit tim...
Ç'është, ç'është kjo-e paana Gjithësi?
Dhe ky rregull dhe ky libër që sheh ti?
Kjo e kaltër hapësirë e paanë.
Këto drita që kufi e numër s'kanë?
Këto yje trupergjëndë e faqeatë,
Që vërtiten me nxitim e dritëqartë?
Kjo natyrë dhe ky det, burim i jetës?
Këto ligje, këto pamje të së fshehtës?
Ç'janë vallë këta trupa gjithë zjarre.
Këto botëra plot dritë shkëlqimtare?
Përplas krahët Kasht' e Kumtërit ngadalë,
Posi shtegthi mu në çerdhen ku ka dalë
Që një botë e re të lindë prej asaj
Dhe të endet me të tjerat kjo pastaj.
Si shigjetë ajo ecën, më s'qëndron,
Nëpër qiellin vërtitet, vallëzon,
Rend gjithmonë dhe qirinë mu në gjë,
Endacake, pa qëndrim e pa shtëpi.
Po nga vallë vjen ajo posi shtërngatë,
Me kaq vrull e derdhur leshërat e gjatë?
Rrugn' e saj nuk mund ta gjejnë sytë tanë,
Se vështrimet e njeriut të shkurtër janë.
Mbështet këmbët mbi eterin dhe vërtitet,
Përshkon qiejt tej e tej që të flladitet,
Shumë i bukur je, o qiel i madhërishëm!
Ngazëllues je, empiri i pakufishëm!
Fund e anë, jo më s'ka kjo hapësira,
Mbushur është plot me trupa e shkëndira,
Mund ta thonë dot të fshehtën qiellore
Këjo gjuhë dhe kjo gojë njerëzore?*

¹ Është interesant të shënohet se Naimi, edhe pse ka imituar në këto vjersha poetët persianë, ngandonjëherë shkon kundër traditës së tyre. Kështu ai e hap këtë tubëz poezish jo me të ashtuquajturin munaxhat (vjersha të fillimit kushtuar Zotit), me të cilin fillojnë veprat e poetëve arabo-iranianë, por me Qiellin, pra me natyrën. Vjersha "Zoti" është vënë nga fundi i veprës (shih nr. 20) (Shënim i shqipëruesit).

² Vargu që përdor Naimi në këtë përmbledhje poetike është po ai që ka përdorur edhe poeti i famshëm turko-iranian, Xhelaluddin Rumiu në veprën e vet monumentale *Mesnevi* (shqipëruesi)

³ Kupto: mendja si zog... (ndikim i stilistikës arabo-iraniene). (shqipëruesi).

*O ti qiell dritëderdhës, magjiplot!
Fund e krye me të fshehta ti je plot.
Një të madhe mençuri⁴ fsheh ti në gji
Të panumërt janë yjet që ke ti.
Ç'është vallë, ah ky ligj i madhërishëm?
Drita, hiri i Krijuesit të fuqishëm.
Dhe pse vdekjes s'i shpëton asgjë në jetë
- Përveç Zotit që ka qenë e do të jetë -
Nuk humbet dhe nukë zhduket asnjë send,
Që të gjitha pranë Zotit zënë vend.
Q'andëj vijnë, atje kthehen përsëri,
Çdo gjë vdiçet veç fytyrës së atij⁵.
Edhe yjet aq të bukur, pamjedlirtë,
Këmbakëmbës i ndjek vdekja e pashpirtë,
Që të nxjerrë nga i riu plakn'e vdarë,
Zoti vdekjen anëmbanë ka shpërndarë.
Do të njohësh të vërtetën o shpirtdlirë?
Asohere Gjithësinë vreje mirë!
Si i ditur hidh një sy nga qielli i lartë!
Të gjesh fron'e madhështisë së llagartë...
Po ti hesht, o krimb i tokës, dhe dëgjo,
Gjer te - e qiellit e fshehta ti mos shko!
Një pik'ujë vrej në botë o i gjorë,
Që të shohësh në të mijëra frymorë!
Mençuri e Zotit shfaqet në çdo vend,
Plotfuqin'e tij shikojmë në çdo send.
Kur kaq drita dhe të fshehta ke përballë,
Mbi të qenët dhe mosgjënë mos bëj fjalë!
Para teje o ti det pa skaj i gjerë,
Më vjen turp, ah, më vjen turp një mijë herë.
Këto fara xhevahiri anëmbanë
Nga e Zotit mbretëri një botë janë.
Mbylle gojën, mos u ndje o ti bilbil,
Krahët ulur rri te yti trëndafil!
Që nga qielli mendja ime të kërcasë,
Në të fshehtëzën e dashur të humbasë.
Të lexoj "fytyrn'e e Zotit ke aty"⁶.
Dhe Selinë⁷ të zbulojnë këta sy.
Se ç'do bëhem pas kësaj më s'di ç'të them,
Pas kësaj, ah s'do të jem, jo s'do të jem....⁸*

⁴ D.m.th. mençuria e Zotit, sipas fesë, e ka krijuar botën në bazë të një plani të paracaktuar dhe me një qëllim të caktuar. (shqipëruesi)

⁵ Fytyrës së Zotit (pjesë e një verseti të Kuranit).

⁶ Pjesë e një verseti të Kur'anit (...ngado që të ktheheni, do të keni përpara fytyrën e Zotit...) (shqipëruesi).

⁷ Selia: froni i Zotit, sipas Kur'anit, si mishërimi i Plotfuqisë hyjnore (shqipëruesi).

⁸ Kemi këtu atë që në gjuhën mistike quhet zhdukje, shkrije, fuzion (fenâ). Vetëm se ndryshe nga mistikët muslimanë, që pretendojnë të shkrihen në personin e Zotit (fenâ fil-lâh), ose në personin e pejgamberit Muhammed (fenâ-fir-Resûl), ose në atë të shehut (fenâ fish-shejh), Naimi shkrihet në njësinë harmonike të Universit.

2. GJUHA E ZEMRËS

*Flet natyra në çdo çast në këtë botë
Dhe të fshehtën që ka brënda shkoqur thotë,
Herë flet me pëshpëritje, mengadalë.
Her' me fjaln' e trupëzuar, her' pa fjalë.
Kaq të fshehta i thotë era trëndafilin,
Këto thotë dhe rënkimi i bilbilit.
Gjithë sendet dhe ç'përmban kjo gjithësi
Nxjerrin shfaqin, kaq të fshehta dhe çudi.
Reja, era, lumi, deti i shkumbëzuar,
Malet, fushat dhe livadhet e bleruar,
Qielli, yjet dhe të tjera një nga një,
Flasin qartë, flasin bukur sa s'ka më.
Prandaj zëmëres kjo gjuh' i është dhënë
Që t'i thot' asaj të fshehtën e pathënë.
Këtë gjuhë e dëgjojnë dijetarët,
Rrugënjohësit e dijes, zbulimtarët.
V. 1874*

3. PRANVERA

*Moj pranverë që të ngjall me frymën tënde
Vashë e brishtë dhe fytyrëzergjëndë!
Jota është e natyrës pamja e dëlirë,
Jotja është e lulishtes era e mirë,
Ty mikeshë të çoi Zoti moj në tokë,
Për të varfërit të bëri mik për kokë.
Era jote ern'e mikes më sjell mua,
Dhe vetit'e saj të shpirtit ti m'i thua.
At' i dhimsur për jetimët je pa fjalë,
Hiri yt, moj bir për nënën që s'ka djalë,
Dora jote rruzullim gjat'e gjerë
E ka bërë nuse, dritë, ngjyr'e erë.
Ngazëllim nga ti ka marrë Gjithësia
Ujërat, drurët, mizat, gjithë shpezëria.
Shpirt nga ti ka marrë toka e pajetë,
prandaj botën po e shoh si dua vetë.
Ti nga qiejët ke ardhur, moj pranverë,
Ta bësh botën një lulishte plot me erë,
Hir ke sjellë nga Selia⁹ ti e brishtë,
E ke bërë botën krejt trëndafilishtë.
Po si Qielli po qesh Toka e çelitur
Po shkon lumi mu në mes duke buçitur.
Çdo mënjollë, bimë e dru veshur me fletë
Veç nga ti, moj, kanë marrë vlag e jetë.
Njeri kryet me kurorë prej floriri,
Tjetri prehrin plot me copa xhevahiri
Shkundërmon nga era bota anekënd
Plot me perle, lale,¹⁰ ar dhe me ergjënd,
Flladi, prozhmet, zogjtë, ujët ndër burime
Janë mbushur plot me tinguj, ligjërime.
Moj pranverë! Meqë ardhur ti na ke
Si kujtim të Perëndisë, moj te ne,
Hidh një sy mbi varrn' e mikes... që zymbyli
Nga savani të shpërthej' e trëndafil,
Një nargjiz¹¹ nga sytë e dehur, të begatë,
Një zymbyle nga cullufeza e gjatë!
Kur të kthehesh tjetërherë - më dëgjo!
Po s'qeshë unë, sipër varrit më kalo!
Nдалu pak te dheu i varrit dhe atbotë
Posi vesë derdh mbi mua ti ca lotë!*

⁹ Froni hyjnor (shqipëruesi).

¹⁰ Lal - gur i çmuar i kuq, si rubini, fjalë që përdoret shumë në poezinë arabo-iraniene për të bërë krahasime (shqipëruesi).

¹¹ Nargjiz - lulja e bathrës. Me nargjizin krahasohen sytë e bukur në poezinë iraniene, ashtu si krahasohen me zymbylin cullufet e vashës dhe me trëndafilin faqet, fytyra ose edhe buzët e kuqe të saj. Shumë herë këto tri lule bëhen simbole përkatësisht të syve, cullufeve dhe të fytyrës (ose buzëve) (shqipëruesi).

*Që të mbij'nga balta ime trëndafili,
Dhe nga eshtërat të dalë, moj zymbyli.
v. 1875*

4. LULJA...

*N'atë kohë kur ky Dielli si fener
Si dhe Toka edhe Hëna - ish eter,
Dhe kur Toka, Hëna, Dielli shkëlqimtar
U bën' avull dhe u mbushën plot me zjarr,
Dhe nga Dielli na u ndanë Tokë e Hënë
Pa u nda dhe Hëna shpejt nga Toka - nënë,
Dhe çdonjëri na u bë në hapësirë
Yll i zjarrtë që ndriçoi në errësirë,
Dhe u shfaq pastaj ky Dhe që vuri korë,
Që u mbush me ujë, bimë e plot frymorë.
Gjatë kohës, pra, që ndodhën kaq çudi,
O moj lule ku qe fshehur vallë ti?...*

5. BILBILI

*Ja, çdo yll që vezullon me aq dritë
Në mes qiellit që është bërë porsitë,
Krej ka heshtur, sytë çelur n'hapësirë,
Një e fshehtëzë, dëgjimn' ja ka përpirë.
Hëna e ndritur në mes shtrojës së qiellit
Sipër vetes se ç'ka hedhur dritn'e diellit.
Si ergjënd të duket Toka nga ndriçimi,
Mbi të rënë kanë hije jasemini.
Posi Hëna bërë bota anembanë,
Qiparizi hedhur shtatin ka si zanë.
Si fytyr'e mikes deti ndënë Hënë.
Si nishanë mbi të hiet kanë rënë.
Si një vashë është bërë kjo natyra
Ta josh shpirtin me stolitë ngjyra-ngjyra.
Si e ngrirë rri boriga e më s'flet,
Gjithë lulet kanë çelur syt'e vet.
Shpërndan ajri kudo vesën sumbullore
Nëpër kopshte, nëpër drunj e hamullore.
S'lëviz gjethja, që nga drunj të rigon lot,
Të mbyt era që ep kopshti luleplot.
Heshtur kanë gjithë druthezat e botës
Para Zotit që s'dëgjon nga dufti i shqotës,
Asnjë zë tashti mbi dhe më nuk dëgjon,
Përveç kroit mërmëronjës që rënkon.
Këtu zgjuar vetëm unë jam tashti,
Përveç meje këtu zgjuar s'ka njëri.¹²
Pa filloj të pyes për romuzet thellë
Herë yjet herë Kashtën, herë Diellë,
Herë Shënjëzat, dhe herë Hënë, Tokën
Herë kthej nga jasemini unë kokën.
Herë flas, ah, me të vdekurit e mjerë
Me të dashurit, me zemrën shpresëprerë,
Tek jam zhytur në mend me këmbë e tokë,
Kur në qiellin e tetë, kur nën tokë,
Befas vjen një i ëmbël zë që përvëlon
Që të fshehtëzën e gjatë më tregon.
Vjen nga qielli dhe më bëhet mik pa druajtje
Vjen nga Zoti dhe më bëhet shok në vuajtje.
Ç'është, ç'është, Zot ky zë plot ëmbëlsi?
Nga vjen vallë, nga vjen vallë - o Perëndi?
Nga vjen vallë, Zot, kjo këngëzë plot joshe?
A nga Toka, e nga kupa kaltëroshe?
Veç një gjuhë thua ka tashti kjo botë
Dhe me të të fshehtën hapur po na thotë.*

¹² Edhe pse poeti nuk u ka shpëtuar përsëritjeve, pjesorja medio-pasive zgjuar që përmendet dy herë në këtë dyvargësh, nuk duhet të jetë një përsëritje e thjeshtë. Me të dytën, si duket, Naimi kërkon të thotë se i ka të çelur jo vetëm sytë e ballit, por edhe ato të zemrës (shqipëruesi).

*O bilbil, o vjershëtori këngëdëlirë,
Këndona këtë të fshehtë të vështirë!
Për mik-trëndafilin tënd gëzohu shumë,
Herë qesh e herë qaj kështu si unë!
Thuaja embël, të dëgjoj i dëshëruar,
Ti hedh poshtë çka kam thënë e kam menduar,
Se na joshi zemrën ky vajtimi yt,
Ky rënkimi, ahu, përvëlimi yt.
zemra brenda po më dridhet kaq shumë,
Shok i zemrës t'u bëra tashti unë.
Ja, prandaj ka heshtur gjithë kjo tërthore.
Të dëgjojë këngën tënde qiellore.
Ja, burbuqja kokën nga këmisha nxjerr,
Të dëgjojë këtë fjalë si sheqer.
Rrotullimin, o Merkur, ndalo një fije
Dhe dëgjo këtë rënkim-o dashurie!
O bilbil, me këtë vaj e psherëtirë
Na këndo këtë të fshehtë të pavdirë!
v. 1880*

6. DURIMI DHE SHPRESA

*O moj kohë e kaluar, je lëndim!
Më dhëmkos e më sjell brengë e hidhërim.
S'mbaj mend tjetër gjë prej teje veç lëngatë
Veç andrrallë, dëshpërim e ah të gjatë
Çdo krajatë që m'i ra zemrës së mjerë
Gjurmë e shenjë lënë ka dhe ndër të tjerë
Kopshti i zemrës nuk më ka më trëndafila,
Asnjë gjethe, asnjë pemë, as zymbyla.
U venit dhe u bë, ah, dhë e ferrë
U cfilit dhe u bë, ah, hi-skëtërrë.
Seç u zhdukën krejt burbuqe, trëndafij,
Sheh kërcejtë krejt të zhveshur dhe të zinj.
Gjersa dot nuk hedh në dorë ç'kam dëshirë,
Jeta është, pra një lelezë e vdirë,
Ashtu posi diell'i dimrit q'herë-herë,
Na nxjerr kokën në mes rresh të zeza sterrë,
Dhe shpërndan një flakë zjarri anëmbanë,
Por që shpejt humbet sërish nga sytë tanë,
Ashtu ndrin në zemrën time rrallë-rrallë
Faqja e shpresës në mes brengash palë-palë,
Por kjo befas zhduket, gjurmë s'le mbi dhe
Dhe mbi dhembje mu në shpirt më lë të re
Sheh së largu një qiri përgjysëm shuar
Dhe shpejt zemra më valon e ngazëlluar,
Plot me shpresa drejt atij nxitoj sa mund,
Por një hie, një mirazh gjej më në fund...
Cili vallë rroi pa brenga e andrralle
Në këtë zuzaren botë kaq rremalle?
Shpirt e zemër në mundim i sheh përherë,
S'kanë tjetër po veç vuajtje, gjëmë - vrerë.
Nga e dredhjes ldeor mat u bëra une,
Po kjo brenga po qëndron ende me dhunë,
Unë nesër do të dal nga bota e shkretë
Por për të mbas meje vdekje s'do të ketë
Në të botës det kjo vark'e jetës sonë
Drejt nga era e mundimit shkon gjithmonë.
Si timon ka ahun, brengën me dënesë,
Vuajtjen, dhëmbjen ka përherë si ngarkesë
Në mes valësh te ky deti si humnerë
Ulet, ngrihet me aq frikë varka e mjerë.
Në çdo çast e sheh në luftë e rrëmujë,
Gjithëmonë në ngushticë-e rrokopujë.
Por nuk mundet që ta hedhë grepin dot
Te ky det me brenga dhe me vuajtje plot.
Shpresën si mirazh përpara ka vërtet;
Kur ç'të shohësh befas zhduket në fundët
Varka mijëra përpin ky det si kjo,
Asnjë dhogë nuk sheh anësh nga ato...*

*Ai që me brunn'e vuajtjes na gatoi,
Zemrës shpresën dhe durimin i dhuroi.
v. 1879*

7. HËNA

*Nga na vjen me kaqë bujë e mengadalë,
Që nga prapa malit befash duke dalë?
Herë shfaqesh, herë fshihesh, s'dukesh më,
Herë nxin dhe herë ndrin që ç'ke me të.
Herë mbushesh plot me dritë hieshie.
Herë bëhesh si një hark e si një hie.
Si kandil për Tokën natën bëhesh ti.
Ecën pas kësaj si t'ishte një fëmi.
Natën ditë ti e bën, por s'nxjerr të fshehtë,
Sa më duhet moj vështrimi yt i lehtë,
Nga na vjen moj vashë e qiellit vallë ti,
Me kaq naze, me kaq dritë e stoli.
Sa e dashur pamja jote ky vështrim!
Drita jote prapa lë, moj çdo ndriçim.
Drita jote: frymëzim për vjershëtorët
Faqa jote: udhëheqës për shenjtorët
Rrotull Tokës ardhur ke që prej fillimit...
Prandaj parë ke të fshehtn'e njerëzimit.
Ti mban mend, moj, atë kohë e lashtësi
Emrin e së cilës nuk e di njeri.
Musaut ti ja bëre Тыrin.¹³ ditë,
Në mes dritës ai gjeti atë dritë...
Kaqë breza kanë ardhë - e kanë shkuar,
Kurse drita jote s'paska, moj, të shuar!
Sa përleshje moj në tokë ti ke parë?
Sa trazime, sa mjerime, sa llahtarë?
Ti ke parë se ç'ka hequr njerëzimi
Ke dëgjuar fjalë e klithma dëshpërimi.
Sa Sokratë na ke parë të helmuar?
Sa Jusufë, pré për ujqër të tërbuar?
E sa kombe, moj ke parë ti në botë,
Që u zhdukën krejt, pa lënë shenjë e skotë?
Sa Solonë, sa Platonë ti ke parë?
Sa Harunë,¹⁴ sa Timurë gjakatarë?
Sa Daranj¹⁵ e Aleksandër emërndjerë?
Dhe pastaj, moj sa Ruso e sa Volterë?
E sa fusha parë ke si Qerbelaja?
Sa të mirë¹⁶ që s'u qeshi fat-murtaja?*

¹³ Tûri: lartësi në vargmalin e Sinait në Palestinë, ku një natë, sipas Biblës dhe Kur'anit, i qe shfaqur Moisiut (Musaut) Zoti si një dritë me shkëlqim të madh. Vihet re se si në këtë "takim hyjnor" Naimi fut elemente të botës materiale (në mes të dritës së Hënës, si Naimi gjeti atë dritë..., dritën e Zotit) (shqipëruesi).

¹⁴ Harun-err Reshid (786-809) i halifi i pestë i Dinastisë abbaside të Bagdadit (750-1258).

¹⁵ Është fjala për Darin (persisht: Darà) III Kodomanin, i cili qe mundur nga Aleksandri i Maqedonisë. Poetët persianë e përmendin dendur emrin e Darit pranë atij të Aleksandrit për të dhënë figurën e kontrastit midis lumturisë dhe mjerimit, simbole të të cilave janë perkatësisht Aleksandri dhe Dari (shqipëruesi.).

¹⁶ Njeri i mirë, njeri i shenjtë.

*Ti ke parë gjith' ndodhitë e kësaj bote,
Gjithë punë dhe çuditë e kësaj Rrote.
E sa njerëz sheh ti sot zemërlënduar!
Sa të tjerë pranë mikes të gëzuar.
Sa të tjerë, moj, që ndarja po i tret.
Plot mall, ahe, dashuri dhe zjarr lebet.
Ti ja di të fshehtat kohës një për një
Por në gjumë është bota dhe s' di gjë...
Sa ke parë ti si mua në andrralla,
Nga ata që s' u la dheu më kokalla?
Por dhe ty vërtitja e kohës, të rroniti.
Të vu këmbën dhe të plaku, të cfiliti.
Edhe pse të shoh nga jasht dritëplotë,
S' është kopësht, moj, përbrënda jeta jote.
Edhe pse më dukesh vashë shtatergjëndë,
S' je veç plakë që s' ke gjak në zemrën tënde.
Dhe pse sipër rrobë të artë na ke hedhur.
Unë e di moj se nga cili e ke vjedhur:
Nga yt gjysh moj, ti merr dritën dhe stolitë
Dhe pastaj ja ep sat ëme, o moj dritë.
Ti nga brinj' e Tokës sonë, moj qe ndarë
Mu ashtu si Hava nga Ademi i mbarë.
Nga i nxehti diell i ndriçëm doli Dheu
Dhe si yll i ri një ditë ky rrënjeu.
Asoherë, moj, nga Dheu u shfaqe ti
Dhe u mbushe plot me dritë si ai.
Veçse Dielli e ka dritën edhe sot,
Dhe kjo Tokë ende pemë na ep plot,
Kurse ty, moj, zjarr i brëndëshëm t' u shua,
Dhe fytyra t' u zbe fare, t' u trishtua.
Ti në vend të Tokës hone ke në gj, i
Nuk ke krymba, këndra, kafshë, shpezëri.
Më s' ke ujë, më s' ke pemë, më s' ke drurë,
Një gërmadhë e ke trupin të sëmurë,
Kthetra e fatit prehërin ta pati zënë,
Si i vdekuri u bëre, o moj Hënë
Por, ç' po flas... pa ty mos mbetë Toka jonë?
Shend e verë paç vështrimin ti gjithmonë!
Shenjta e përjetësisë shoh te ti,
Kot kam folur e menduar gjer tashti
Plot me dritë qofsh në botë ti përjetë
Pa ty, Hënë, kurrë Qielli mos mbettë!
Drita jote i sjell shpresën njerëzisë,
Lajm të mirë sjell mbi dhë prej lartësisë
Drita jote sapo bie moj, përdhe,
Mik i dashur bëhet për të gjithë ne.
Faqa e detit bëhet soje si ergjënd,
Përarohen malet, fushat anekënd.
Dritën tënde çon ti poshtë, atëherë
Posi perlë shndrit toka gjatë e gjerë,*

*Bëshesh me të botës gjindje shok besnik
Ulesh bashkë me të mjerët si një mik.*

*Bëhu shok i zemrës sime vajeplote,
Dhe tregoi asaj çdo gjë të kësaj bote!
Që të shkojë me dritën tënde lart mbi pllaja,
Sipër ajrit, sipër drurësh mbi ograja,
Mbi zambakë, trëndafij e jargavanë,
Mbi ndënkresë ballergjëndësh... tulipanë.
Mos dil kurrë, Hënë moj, nga rruga jote!
Që të mos të t'ërret pamja dritëplote.
Që të mos të t'bëhen qiejt ferr e zi
Që të mos të t'ngecë këmba n'yzengji.
Teje nxura dashuri dhe përvëlime.
Dhe një zjarr i madh m'u ndez në zemrën time.
Edhe pse një hi si ti në dukje jam.
Një të madhe flakë, moj, në zemër kam.
Ty t'u ftohën edhe gjaku edhe gjitë,
Por kjo zemër po rënkon po heq të zitë,
Ty nga Dielli të vjen dritëza e dëlirë
Kurse unë dritn'e fshehtë kam përpirë.
Mendja ime rrotull po të vjen tashti.
Ndofta dritë gjen në dritën që hedh ti.
v. 1881*

8. DASHURIA

*O moj flak'e dashurisë! Ç'e do fare
Atë jetë kur s'je ti, moj shkëlqimtare?
Mos ik kurrë nga kjo zemra plot mjerime!
Mos u fshih as për një ças nga mendja ime!
Se me ty, moj zemra ime ka jetuar,
Të ka shoqe që nga koh'e amëshuar,
Ndofta Zoti zemrën mbrujtur pat me ty
O në zemër të pat hedhur ty ay.
Edhe pse s'po shoh veç ahut, moj, prej teje,
Prapë, ky m'i bëhet zemrës rrug'hareje.
Me mundimin shpirt më ep, moj, dashuri,
Prorë-e dashur m'është zhytja që sjell ti.
Që ta bënte njeri baltën, Zoti shpejt
Nga yt det një pikë hodhi mbi të drejt.*

9. FILOZOFI

*Në mëngjes kur Tokë e Qiell i mbyt shkëlqimi,
Dhe u qesh fytyra e bukur nga gëzimi,
O në kohën e mesditës kur bën nxehtë,
Kur nga vapa zë sekush një çip të qetë
Dhe kur këngën lë trumcaku menjëherë
Dhe tulatet në mes gjethesh që të flerë
O në kohën kur ylli i zjarrtë, Dielli
I bën shenjë me sy Tokës që nga Qielli.
O aherë kur nga ftohja me vorë
Borë e bardhë bie nga e zeza ré
O aherë kur njom shiu dhen'e thatë
Dhe e bën si kopësht tokën gjerë e gjatë.
Sidomos kur vjen pranvera aq hiroshë.
Që nga plakë e bën botën bukuroshë,
Dhe e mbush tërthoren plot me këngë e ngjyra
Kurse qielli qesh e ndrin posi pasqyra,
Dhe dëshira vlon në shpirt te çdo i gjallë
Dhe ç'ka toka mërmëron e thotë fjalë,
Dhe e qiellit ngjyra e çelur të flladit
Dhe e Tokës faqe e dashur të çelit:
Mëndja ime, që s'gjen prehje, bën kërkime
Dhe rropatet me aq pyetje e mërmërimë
Kush? Pse? Çfarë? Ku e kur? E si e sa?...
Por më kot se nga çdo anë tallje ka;
Poshtë e lart i bie botes me aq zhurmë
Për të gjetur ndonjë shenjë, ndonjë gjurmë;
Këta trupa këto ligje vallë ç'janë?
Ç'është bota që s'ka krye, fund e anë?
Shikon faqet kjo.¹⁷ të librit Gjithësi,
Këto shkronja plot të thella fshehtësi:
Ç'janë gjithë këta yj e llamburitje?
Këto gjëra kaq të fshehta dhe vërtitje?
Një pik'ujë është gjithë ç'dimë ne,
Kurse botën det pa breng e fund e ke.
Zogu i mëndjes te ky deti kaq i gjerë
Më fundoset poshtë ingjirit si humnerë.
Shkrehet, mbetet pa mbështetje e topitur
I pazoti, nga dyshimi i nemitur.
Shkon me bujë, i rrëmbyer me poterë
Por këthehet i cfilitur, krahëprerë.*

*Thelbin tënd s'e di njeriu, moj natyrë,
Dhe pse thellë kësaj fushe i ka hyrë.*

¹⁷ Mëndja (shqipëruesi)

10. DIMRI

*Ç'ka kjo botë që gërmadhë është bërë?
Një kasolle vaj-rënkimi qielli tërë!
Ç'u bë vera që s'e shohim më në tokë?
Ç'pati bota, ç'gjëmë vallë-i ra mbi kokë?
Kopshti, këngët dhe bilbilat, ligjëritë,
Qielli i bukur plot me ngjyra, plot me dritë,
Krejt u zhdukën, gjurmë syresh nuk sheh dot
Thua bota tjetër është bërë sot.
Thua vdekur ka sot kopshti që s'bleron
Mbi kufomën e tij korbi po vajton.
Ç'është o Zot, ky tym i zi në hapësirë?
E ku shkuan Dielli i ngrohtë, qielli i dëlirë?
Mu në pus na ra Jusufi me brez t'artë,
Prandaj ahu mbushi qiellin e llagartë.¹⁸
Thua zjarri-u dogj galonjat.¹⁹ Hënës, Diellit,
Nga ky zjarr ka mbetur tymi i zi i qiellit.
Si i vdekuri ka ngrirë gjithë toka,
Një savan po shoh në fusha, male, boka.
E ç'u bënë zogjt'e këndrat mizëri,
Q'asnjë shenjë nuk po shoh prej sish tashti?
Gjithë qënëjet u zhdukën, humbën fare,
Nga çdo anë shfren duhia rrënimtare.
Mbushur qielli plot tym ahu dhe rënkimi,
Po shfren moti plot me shkulme zemërimi.
Bërë bota posi leshrat e një plake
Nga kjo Rrota e pabesë, dredharake.
Është fshehur qielli i rimtë, prandaj sot
Nga i tiji hir më shenjë s'po shoh dot
Fletë e kokrra nëpër drurët s'po shoh më
S'ka më lule, s'ka pëllumba, s'ka asgjë.
Zogj e këndra pa thërrime kanë mbetur
Të cfilitur, të drobitur e të tretur,
Ajo gjë që nxin mbi kokën e janarit
Është ah... dhe s'është, s'është tym i zjarrit.
Moj pranverë, e ti mbret i bujarisë!
O ti lajmëtar i hirit, begatisë!
Eja prap', o hir i madh, në këto vende,
Ferrin prap'Eden ta bësh me dorën tënde!
Një livadh ta bësh ti botën anëmbanë!
Që të mbushet trëndafij e jargavanë;*

¹⁸ Figurë poetike e ndërlikuar për të treguar largimin e diellit në dimër. Dielli është shëmbëlyerr me Jusufin (Jozefin) brezart (në shumë piktura Jozefi i bukur i Biblës paraqitet me një brez të artë në mes), që ka rënë në pus (dielli ka rënë në errësirën e dimrit që i shëmbëllen, pusi ku qe hedhur Jozefi nga vëllezërit resetarë). Prandaj edhe retë e zeza të dimrit nuk janë tjetër por ahu i shkaktuar nga kjo tragjedi kozmike që është pikërisht si ahu që pat bërë të dalë nga zemrat e njerëzve humbja e vajtueshme e Jozefit të Kananit (shqipëruesi).

¹⁹ Galonja - pallate, saraje (fjalë përdorur në krahinat e rrethit të Beratit (shqipëruesi)).

*Që kasollja e brengës t' bëhet kopsht me erë
Që të mos humbasë nderi n' asnjë derë...
Qe të varfërit mbi barin t' i shoh shtrirë,
Nën të qiellit kupore krejt të lirë.
v. 1878*

11. MBI VARRET E MOTRAVET DHE TË VËLLEZËRVET

*Leri pak bilbilat, trëndafili em!
Sepse dua nja dy fjalë të të them:
Më kujtohet se ti vjet nga ne qe zhdukur,
Por sivjet posa që hyri stina e bukur.
Ti u shfaqe prap, se vera të dha shpirt.
Po a je ai që ishe sot një vit?
Nga i more këtë er'e këtë ngjyrë.
Shtatn'e bukur dhe të këndëshmen fytyrë?
Posi miku im... i vdekur qe ti dje,
Por me bujë erdhe sot sërish te ne.
Duket se nga vendi i mikut po vjen ti,
Që nga lagje e të dashurve të mi.
Ern'e tyre marr nga yti kundërmim.
Një të fshehtë ka këtu, ah pa dyshim.
O ti mbret, o shumë i larti kryetar!
Nga e dëlirta fryma jote unë marr
Të Edenit erën, hirin parajsor.
O Hasan Tahsin²⁰ - o trëndafil²¹ - qiellor!
Gjatë dimrit pranë teje kaqë herë
Jo pse doja të shëtitja si në verë,
Po nga zjarri që të shihja këtë dhé
Këtë baltë kaq të dëlirë që më ke,
Pata ardhur zemërdjegur, përvëlur
I vrerosur, i brengosur, i helmuar.
Unë thashë²² - se mos vdiqe, humbe krejt,
Po ti paske shkuar nga parajsa drejt.
Nga parajsa sot ti kthyer je sërish,
Kryet nxjerrë ke mes kopshtesh e stolish.
Ti më vjen ga trupi, dheu, shpirt i ndritur.*

*Një trup janë këto drudhëza të botës:
Diell e Hënë, njerëz, këndra, drunj të Tokës.
Ndaj shpërthen nga dheu lulja plot me erë
Se aty kaq ballëhëna ke përherë...
Trëndafil o n'ato kopshte ku qe ti
I pe vallë ti të dashurit e mi?
Në i pafsh edhe një herë, o lajmëtar,
Po, lajmtar me erë myshku, blerimtar
Një të falë të m'u çosh me gjuhën tënde,
Dhe pastaj sillmë një lajm nga ato vënde!*

²⁰ Emrat e njerëzve me prejardhje arabe në ish-Perandorinë turke përbëheshin rregullisht prej dy emrash nga të cilët i dyti perdorej si epitete.

²¹ Njëpërmet figurës së lules që del sipër varrit - motiv që e ndeshim midis shumë të tjerëve - edhe te Saadiu - shprehet ideja e pavdekësisë së kujtimit, të veprës, të punës së njeriut, ose më drejt vetë ideja e pavdekësisë së racës njerëzore (shqipëruesi).

²² Unë thashë: unë kujtova.

12. DIELLI

*Me sy shenja njëri-tjetrit duke i bërë
Yjet lart-lart në qiell po sërë-sërë.
Ca nga ca tërthoren drita po pushon
Po shpërndahet errësira posi hon.
Nëpër boka, ja, thëllëza po baret.
Qan nga ndarja prej të dashurit të vet.
Sërish këngën thirrja, o bilbil finosh!
Sipër drurësh ti sakaq të fluturosh!
Ja dhe Dielli dalëngadalë po na del
Nga vështrimi i tij agimi po na çel.
Qofsh përjet', o ylli ynë, paç bekim!
Drit' mbi drit'je... dhe shkëlqim përmbi shkëlqim.
Kur ti fshihesh, toka vrohet si në zi...²³
I qesh buza, ngazëllohet kur vjen ti
Para teje nata krismën merr sa mund,
Dridhet, fshihet dhe më s' duket asgjëkund.
Dhé që bërë yll'i Tokës teje ndarë,
Ahu i zemrës kraharorin ja pat çarë.
Ti i fale jetë lëmshit tokësor,
Ti ja ep ndriçimin rruzullit qiellor.
Teje kanë lindur yjet endacakë.
Drita jote i ka ndezur posi flakë.
Bija jote është endacakja Tokë,
Afërdita dhe Merkuri me kaq shokë.
Qëkur teje këto dritëza u ndanë
Si pa mend enden qiellit të paanë.
Para teje, o ti Diell, që dritë je.
Mizë janë dhe njeriu dhe ky Dhé.
Por' dhe ti o mbret i botës ta dish mirë
Nuk je tjetër veç një yll në hapësirë.
Para gjithë rruzullimit të pafund.
Ti, o Diell, s'hyn në numër asgjëkund.
Se sa trupa ka të ndritur, madhështorë!
Por i shkurtër është syri ynë i gjorë.²⁴
Posi ti dhe këta trupa diej janë,
Dritë e hir e madhësi më shumë kanë,
Mendja ime djathtas, majtas fluturon,
Që të shohë hapësirën gjer ku shkon.
Fluturon, por fund e anë s'gjen kurrkund,
Kokë ulur prapë kthehet më në fund.
Kjo e gjera hapësirë pa kufi
Kaqë drita e të fshehta mban në gji.*

²³ Shfaqja e jashtme e zisë është rroba e zezë që lidhet sipër tokës sa kohë që s' duket dielli (shqipëruesi).

²⁴ Këtë mendim të Naimit duhet shpjeguar me gjendjen e njohurive të shkencës astronomike nga mesi i qindvjeçarit të kaluar e jo me bindjen absolute të tij, si një bindje e formuar nën ndikimin e mistikëve dhe të idealistëve që nuk kanë besim në aftësitë e pakufizuara njohëse të njeriut (shqipëruesi).

*Djathtas, majtas s'ka natyra as dhe s'kaj,
Të panumërt janë trupat e kësaj.
Mençuri pa si e sa, pa shëmbëllim!
Plotfuqi që s'ka fillim dhe as mbarim!
Rrofsh përjetë, o ti shpirt i Gjithësisë!
O ti det pa skaj, pa fund i gjallërisë!
Dritën tënde kam vravashkë o ti Diell...²⁵
Me të tuat rreze ngjitem gjer në qiell.
Sheh në qiell ti moj zëmërez e shkretë
Një të bukur prak që vdekje do mos ketë.
Ai zokth që te kjo çerdhe është mësuar.
Edhe krahët po këtu ia ka përvluar...
v. 1881*

²⁵ Të duket sikur Naimi kalon nga dielli i qiellit tonë në diellin e mistikëve që qënka diku jasht kufijve të kohës e të hapësirës. Por më shumë ka të ngjarë që të jetë fjala gjithmonë për qiellin tonë i kthyer tani në simbol: drita e shkencës, me anën e së cilës poeti depërton në fshehtësitë e kozmosit. Si duket, Naimi ngul këmbë se nuk mund të ketë përparim shpirtëror (ideal i mistikëve) jasht jetës reale dhe pa ndikimin dhe ndihmën e elementëve të botës materiale (Shih vejrshën nr. 7 për rolin e dritës së Hënës në takimin e Musaut (Mojsiut) me Zotin në malin e Tûrit) (shqipëruesi).

13. ANËS LUMIT

*Sa më josh o lumë mërmërimi yt,
Lajkat, lodrat, fshehtësi' rënkimi yt!
Dhe pse zemrën ma lëndon ti me këto,
Nga lëndimi e kënditur është kjo.
Nëpër gurët shkon si rreshme, me nxitim.
I shushatur plot me lotë e rënkim
Herë shkon duke dredhur, herë drejt,
Herë shkon duke çaluar, herë shpejt.
Herë rrjedh me kaqë naze tatëpjetë.
Herë hovshëm si të ishe një shigjetë.
Herë shkon përmes lugajës që bleron,
Herë nën të drunjvet degë gjarpëron.
Herë shkon me vrull si kali që s'ka fre,
Me rrëmbim, i shkumbëzuar, si voré.
Herë vjen me këngë, herë vjen me valle,
Herë shpejt si zog dhe herë mengadale.
Qëkur ike nga i dashur zemërdëlirti...
Për atë që aq fort ta donte shpirti,
Ti nxiton pa këmb'e kokë... si kusari,
Her'i qeshur her'i shkrirë krejt së qari.
Zjarri i diellit ty të ndau nga ai.
Re e krismë u bë ahu yt i zi.
Dhe nga ahu i ndarjes sate, o qyqar,
Dhe nga lotët që të rrjedhin kalivar,
Re të zeza e mbulojnë gjithë qiellin,
Dhe e zënë, dhe e fshehin fare diellin.
Anembanë ngryset, nxihet hapësira
Posi zemrat plot mëkate të pështira
Dhe papritur nëpër qiellin si skëterrë
Vetëtimat shkrepëtijnë me poterë
Flakë ndizet tashti qielli anembanë
Dridhet bota nga llahtara që ka pranë.
Nuk sheh veç se re të zeza, shi, rrëmuje
Nuk shikon veç shkrepëtima, tym e ujë.
Dhe kështu me këto lajka me stuhi,
Ti në tok' o nazemadh, vjen përsëri.
Që ajo të çelet shpejt me hirin tënd
Nga takimi yt të vishet me gazmend.
Digjen lulet që të shohin vetëm ty.
Toka e vdekur nga ty çelet e merr jetë
Bëhet kopsht e lulishte e vërtetë
Er'e ngjyrë sjell nga qielli ti këtu.
Kopsht parajse e bën botën ti kështu.
Herë borë, herë bëhesh shi e re
Herë ujë, herë avull e rrufe.
Herë shkon nga qielli, herë poshtë zbret,
Bëhesh lumë dhe me kaq vertikal rrëshqet.*

*Ja, mbasi ke ngjallë e dëlirë tokn'e tharë,
Dhe mbasi kaq male e fushëza ke çarë.
Pranë mikut shkon tashti ti i gëzuar,
Pa u ndalur, me nxitim, duke kënduar.
Gjersa të mos kesh takuar mikn'e ndjerë
Në rënkim e vaj do jesh ti kurdoherë.*

14. TOKA DHE NJERIU

*Kjo tokë që aq baltë ka rruftur.
Një yll është nga të qiellit yj të ndritur.
Nëpër qiej udhëton ajo aq mirë,
Posi zogu fluturon në hapësirë.
S'është veç një copëzë e diell fenerit
Dhe një yllth si gjithë bijtë e eterit.
Diellin zjarrpërhapës ka ajo si nënë
Dhe si bijë këmbëlehtn' bukur Hënë.
Ka si motra: Mars, Saturn e Afërditë;
Peshk e Dash, Binjakë: shokë i ka përditë.
Plot me zjarrn' e diellit mbushur e ka gjinë
Kaq të mira nxjerr nga zemra mbi siprinë.
Nga zjarr zemr'e saj dhe sytë plot magji
Kanë dalë këto gjëra që sheh ti.
Bimë e xehe që nuk numërohen dot,
Kaqë lule dhe kaq drunj me pemë plot.
Soje duallën frymoret farë-farë,
Më në fund u shfaq dhe ky njeriu i mbarë.*

*Pranë Tokës rri gëzohu o njeri!
Se kjo tokë u bë, pra, për ty shtëpi.²⁶
Meqë u vure si mëkembës.²⁷ te ky Dhë
Pra, këtu kërko edhe gaz edhe hare.
Dhe pse shkojnë e vdesin njerëzit e shkretë
Për njerinë vdekje kurrë s'do të ketë.*

²⁶ Meritë tjetër e madhe e Naimit: në kundërshtim me pikëpamjet asketike të mistikëve se shtëpia e lumturisë është qielli, duke mohuar kështu idealet e jetës tokësore, poeti ynë beson se lumturia e vërtetë krijohet në tokë, me jetën tokësore, me punën dhe përpjekjet e vetë njerëzve (shqipëruesi).

²⁷ Njeriu në Kur'an cilësohet si mëkembës (halif) i Perëndisë në tokë (shqipëruesi).

15. LAMTUMIRË

*Lamtumirë o ju shokë, lamtumirë!
Lamtumirë, o miq për kokë, lamtumirë!
Lamtumirë male, fusha e burime!
O moj tokë, o livadhe plot blerime!
Lamtumir' o qiell, diell, yj me dritë!
O atdhe, moj kohë, o moj natë e ditë!
Silli tokës hirin tënd, o moj pranverë,
Më kujto pastaj dhe mua ti njëherë!
O bilbil trego ti brengn'e zemrës sime.
Me atë gjuhn'e zemrës plot me përvëlime.
Shpirti im-o, hapi krahët përsëri.
Lart në qiejë, drejt nga Zoti sulu ti!*

*Dhe pse kryeneçe që rropatet kot,
Zemra me atë e mbushur është plot.*

16. JETIMI

*Kur mendoj se ç'heq i varfëri jetim,
Zemrën ma pushton i thellë pikëllim.
Nuk ka nënë ditëziu as baba,
Nuk ka njerëz, nuk ka motër, s'ka vëlla.
Është i vetëm, i brengosur i urishëm.
Si një gur në mes të lumit të furishëm
Ne vallzojmë plot hare nga qelqi i verës,
Ai qan, si plepi dridhet në mes t'erës.
Kush e bën atë të qesh'i ngazëlluar,
Pa dyshim të vetën zemër ka gëzuar,
Zemra që nuk çahet nga i tiji vrerë,
S'është zemër, gur i thuaj një mijë herë!
S'është zemër po nuk njohu dhembshurinë
Është baltë n'është se nuk do njerinë.*

*Dridhu zemër, nga ky ah, nga ky rënkim!
Dridhu, o njeri, o qiell, pa pushim!*

17. ATDHEU

*O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka
Më je nënë, më je motër, më je vlla.
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.
Ty përditë të pat parë ime nënë,
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.
Nëmëruar ti pat lulet syri i saj.
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.
Ti i ke parë gjysh-stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtrat tretur ua ke po ti.
Nga ti, shpirt-o kurrë s'qenë ndarë.
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.
Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë.
Dhe pse ha o dhé ti bijtë e tu të mjerë,
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.
Begatoje o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithëmon'armiqtë e tij!
Gaz përjetë paçin zotërit e tij!
I begatë i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë plot me lumturi!*

18. NË BREG TË DETIT

*O ti det që t'ep flladitje e gëzim
Te ti gazin më gjen zemra, shpirti im.
Pika jote është mëria e ujërave
Ato Isa, kurse ti je Merjeme
Ajo që si zog mbi male ka qëndruar,
- Që më duket si fanitje-e avulluar;
Pjella jote është ujtë lart atje,
Që ta mori dielli dhe ta bëri re.
Në çdo hap një ngjyrë tjetër merr ai,
Herë bardhë, herë i kuq e herë i zi.
Zjarri i diellit e tërheq drejt lartësish,
Por shpejt koha ty ta kthen atë sërish.
Të mos ishte uji, shiu yt si gurrë,
Të mos ish ai vështrim plot zjarr e dritë,
Ku ti gjente toka gazin dhe stolitë.
Ç'më fsheh zemra e dëgjoj në tënden valë
Të shoh ty dhe nyjën time zgjidh ngadalë
Pranë teje vjen të lumit këta ujë
Me nxitim, me ligjërime, me burbujë.
Kaqë drurë gjithë veshur me blerim.
Anës tij radhitur janë me nderim.
Kryet gjer në qiell ka ngritur njëri sish
Tjetri s'është veç një bisk çelur sërish
Krejt përkulur degëzat mbi ujn'e qetë,
Thurur gjethet midis syresh si gërshetë.
Andej gumëzhim 'e detit valëshumë,
Këtej ligjërime e të shpejtit lumë.
Te livadhi po kullosin bagëtia
Prapa blegërin e shqerravet moria.
Poshtë drunjvet, përmes kopshtesh duke çarë
Rrëshqet kroi me të qeshur, me të qeshur me të qarë
Gjithë zogjtë lart në ajër vijn'e shkojnë,
Enden, sillen rreth e rrotull e këndojnë.
Ngritur kokën bagëtia nëpër pllaja,
Plot me fjalë drurët më të larta maja.
Deti, qielli edhe shpezët dhe blerimi,
Gjithë drurët, gjithë gjethet dhe burimi
Po vallzojnë 'e ligjërojnë sot nga zjarri
Thua se janë Mensuri.²⁸ te litari.
Thurur ka çdonjëri syresh një përrallë
Mbushur bota dashuri e zjarre valë.
Qielli i bruzët dhe të tijat fshehtësi,*

²⁸ Mistik musliman i qindvjeçarit IX, që u var nga halifët e Bagdadit me akuzën se në njërin nga vegimet e tij kishte shqiptuar fjalë që ishin në kundërshtim me parimet e Islamit (ai pat thënë, unë jam Zoti, shprehje e cila qe kundruar nga disa mistikë bashkëkohës të mëvonshëm si një orvatje për të zëvendësuar kultin e Zotit me atë të njeriut). Thonë se Mensuri i sjellur përpara trekëmbëshit pat recituar disa vargje mallëngjyese dhe të përvajshme, me të cilat shprehte pikëllimin e tij të thellë që po ndahej nga jeta (shqipëruesi).

*Toka jonë dhe të sajat begati,
Kjo pranverë, këta zogj, këto kullota
Drurët, krojet dhe livadhet, gjithë bota;
Që të gjitha valët e një deti janë,
Këto pikë, ai det pa fund e anë...
Qelqi verë-e vera qelq u bë tashti,
Shpirti trup e trupi shpirt u bë, u shkri;
Shega shark dhe sharku shegë na u bë,
E vështirë të dallohen tashtimë...
v. 1876*

19. MBI TRUPIN E BIJËS SIME TË VDEKUR

*Mjeri unë vaj moj bijë, mjeri unë!
Moj e dashur, moj e ëmbla aq shumë!²⁹
Pa ty mbeta, pa ty mbeta moj në botë,
U shkretofsh o qiell, moj zuzarja Rrotë!
Bathra e kopështit të botës po shndrit,
Kurse bathra e kopshtit tim,³⁰ moj, u venit.
Dhé do bëhet faqja jote trandafile
Dhe cullufeza e bukur si zymbyle
Re për krimbat ajo dor' ai kërci,
Nën të errtin dhé, në varrin ferr të zi!
Farë që nuk vlente hodhe ti në arë
Ah, o qiell, o ti bujku plak trutharë.
Vallë ç'faj ka bërë ky njeriu i ngratë
Që të shohë kaq gjëmë e krajatë?*

Një tjetër

*Larg nga bota më gremisi, ah, kjo Rrotë,
Që të mbetem në mundime e në lotë
Që një mall të ri të kem mbi malln'e vjetër,
Pranë ndarjes të shijoj një ndarje tjetër.
Dot mburojë s'gjeta ndaj së ndarjes zhgjetë,
Ndaj po vij, o moj e babës shpirti vetë!
Po, për ty kam ardhur, ah moj shpirti im,
Që të hysh në gjirin tim, me gëzim.
Të kam ardhur shpresëplot e i trishtuar.
Kur i qeshur, kur i zyrtë, i menduar.
Po nuk gjej veç trupin tënd në këtë dhé
Zogu i shpirtit shkret e la tënden fole.
Gjuha jote dhe ajo nënqeshja jote.
Lajkat, nazet, shija jote magjiplote,
Ajo sjellje, ai gaz, ai vështrim.
Ato fjalët plot endirë e ledhatim:
Që të gjitha, ah u zhdukën, moj përjetë!...
Ngazëllim e shpresë zemra s'do më ketë.
Prandaj fati më largoi moj nga ti
Që të mos të t'shoh ty gjallë përsëri.³¹*

²⁹ Naimi në këtë dyvargësh krijon një aliteracion të bukur me anën e përsëritjes disa herë me radhë të tingullit *d*, duke dashur të japë kështu ndijimin e dhembjes e të tronditjes shpirtërore, shkaktuar nga vdekja e së bijës (shqipëruesi).

³⁰ Nënkupto: sytë që u errën nga vdekja. Për bathën (groshën -nargjizin), trëndafilin, zymbylin, shih shënimet më sipër (shqipëruesi).

³¹ Varg i errët - ndoshta Naimi, sipas fesë, bën aluzion te ringjallja pas vdekjes. Duke qenë i varrosur larg bijës së vet, poeti i ringjallur nuk do të ketë mundësi ta shohë atë, gjithashtu të ringjallur. Por mund të jetë edhe diçka tjetër: Naimi beson në mënyrë poetike e konvencionale dhe, jo si metampsiokozist, megjithëse bektashi-bektashinjtë më shumë mendojnë nga forca e traditës familjare se sa nga bindja e tyre e brendshme - se njeriu vazhdon të jetojë edhe pas vdekjes në formën e lules që del sipër varrit (motiv ky që do të dalë më qartë te *Lulet e Verës*). Po të jetë kjo, asoherë kuptimi i vargut është: duke qenë larg, poeti nuk ka mundësi ta shohë të bijën që vazhdon të jetojë në formën e një luleje që mbin nga varri (shqipëruesi).

Një tjetër

*Zemra e verbër që e kam, moj, sot në zi.
Dje e lumtur ish me tënden bukuri.
Ferr i zi më duket gjithë bota sot
Ahu, zia zemrën mbushur ma ka plot.
Qau jot ëmë e më s'pat të ngushëlluar
Ç'ju rronit, moj, zemra e përvëlur
Dhé i zi t'u bë nënoja, mjerë ne!
Dhe tët motërzë sot savan, moj, sot e ke³².
Gjersa na u fshehe ti nga jet'e shkretë,
Zemra jonë pikëllimin ka përjetë.
Gjersa vdiqë ti moj qokë e zemrës sonë,
Gazin, prehjen na i more përgjithmonë.
Gjersa në shtëpi s'dëgjojmë zërin tënd,
A ka më, moj shpirti ynë jetë e shend?
Qesh e çelet jasemini çdo pranverë,
Kurse ti, ah, ndënë dhé, moj, je përherë.
S'do ta shoh më ty fytyrën unë i mjeri?
As dhe shtatin, as dhe leshrat er'amberi?
Ububu, moj, ububu moj, ububu!...*
v. 1882

³² Siç duket, Naimit i paska vdekur edhe një bijë tjetër (ose ndonjë mbesë) ndoshta e vogël, që nuk duhet t'i ketë dhënë poetit dhembjen që i ka dhënë kjo, të cilën ai e qan me vargjet e sipërme. Nga fjalët e vjershës kuptohet se vasha e dytë duhet të ketë vdekur pas sëmës (kjo është ende savan, kurse e ëma është bërë dhé) (shqipëreusi).

20. ZOTI³³

*Kupa e lartë që s'ka fund e s'ka kufi.
Qielli që shpërndan ergjënd e derdh flori...
Qendërbukuronjësit.³⁴ pa numërim,
Endacakët që vozitin pa pushim,
Në çdo çast e çdo mëngjes e çdo ndajnatë
Ç'të sheh syri në tërthoren gjër'e gjatë
Gjithë lulet, trajta e tyre, ngjyra, era
Gjithë drunjte, kokrrat, gjethet dhe të tjera,
Zhegu ftohja dhe pranvera bukuroshe,
Era, kroi dhe lëndina gjelbëroshe,
Bota e zogjvet me të emblat ligjërime,
Gjithësia, me të fshehtat kupëtime:
Që të gjitha i falen Zotit të krijimit.
Pa lexo këtë fletore të besimit!
Në çdo vend që hedh njeriu të zbehtin sy,
Dritn'e Zotit të vërtetë sheh aty.
Plotfuqi pa shëmbëllim e pa kufi...
Mençuri që s'e rrok mëndja. Perëndi!
Krejt i lashë thashethemet tanimë,
S'do dëgjoj veç gjuhën që më flet pa zë:
Kjo kupore e pafund që kemi sipër,
Këto shkronja, këto radhë dhe ky libër:
Të atij fytyrën shfaqin gjith'këto.
Lexo veten, o njeri, këtu kërko!³⁵
Se je ti mëkëmbësi i tij në jetë,
Vendi prej nga del, sheh thesari i fshehtë,
Pikëz e të thellit det të gjallërisë,
Dhe një afsh nga shpirti i madh i Gjithësisë.
Për Krijuesin e përsosur flet çdo send,
Hirin e fytyrn'e tij shoh në çdo vend.
Zemra që s'pushon së hedhuri në gjij
Flet për të dhe për të fshehtëzën e tij.
Lajme nga ai më sjell çdo gjë e gjallë,
Emrin e atij çdo lule ka në ballë.
Gjithë gjërat që nuk numëron dot
Shqipërojnë emrin e Krijuesit-Zot.
Dashurojn'atë pa dridhen yjt'e dëlirë
Pa kokë e pa kembë enden n'hapësirë,
Enden dhe secili sish në vend të vet
Dhe nga rruga e tij kurrë nuk rrëshqet.*

³³ Kjo vjershë që, sipas traditës së pathyeshme të poetëve arabo-persianë duhej të mbante nr. 1, sado vonë që të jetë shkruar, mban përkundrazi nr. 20 duke ia lënë vendin e nderit vjershës Qielli, me të cilën hapet kjo përmbledhje poetike. Kjo mund të shpjegohet para së gjithash me tërheqjen e madhe që duhet të ketë ushtruar natyra te Naimi. Por mund të shpjegohet dhe me nevojën që do të ketë ndjerë poeti për ngushëllim pas atij mjerimesh që i patën rënë mbi kokë (shqipëruesi).

³⁴ Yjet që sot stolisin galaktikën tonë, që është marrë këtu si qendër e Universit (shqipëruesi).

³⁵ Sipas aforizmës së grekërve të vjetër: Njih veten! dhe asaj të Muhammedit a.s.: "Kush njeh veten, ka njohur Zotin" (shqipëruesi).

*Njëri duke u vërtitur diç rrëfen.
Tjetri duke vezulluar diç zbërthen.
Ai është shpirtdhuronjës i empirit,
Dhe burim i jetës, dritës dhe i hirit.
Nuk ka fund çudi e tij, nuk ka kufi
S'numërohen dot të tijat fshehtësi.
Te njeriu ke pasqyrn 'e Perëndisë,
Ndaj hiq dorë o njeri, prej ligësisë!
Nga e drejta rrugë kurrë mos u ndaj,
Të mos thuash: Ç'bëra unë, ah pastaj.
Bëhu shok e mik me gjithë njerëzinë!
Mërgo shtypjen, ligësinë dhe mërinë!
E si munden që të bëhen pluhur vallë
Vepra e mirë, shpirti dëlirë, zemra e gjallë?
Po qe se nuk do njerinë, s'je njeri.
Shpirt e zemër s'janë gjë pa dëlirësi,
Ai bir që do njerinë, ai ka Zot,
Ndaj nga zemra jote kthehu vështrimplot!
Ne e dinim ndryshe, rrugn e Perëndisë
Pa e lamë dashurin 'ndaj njerëzisë.
Dlire shpirtin, o ti miku besëdëlirë,
Që kështu të gjesh pastaj të Zotit hirë!
Ndrite zemrën, mbaje larg nga ligësitë
Që të bjerë tek ajo e madhja dritë!...*
v. 1882

21. MBI VARRIN E SIME MOTËR

*Pranë varrit po të vij, moj, përsëri,
Zemërdjegur, buzëmvrojtur dhe në zi,
Nuk po gjej këtu nga ti asnjë kujtim
Përveç dheut, moj, të varrit, - ah ç'mjerim!
Por, mbasi ka gjashtë vjet që jemi ndarë,
Si takim e quaj të vij të të shoh varrë.
Qysh se u largova prej teje moj perjetë,
Jam larguar edhe nga varri yt i shkretë
A më njeh moj motër, vallë kush jam unë?
Po a s'jam moj, yt vëlla që doje shumë?
Meqë ndarja e roniti shpirtin tim.
Pranë varrit t'erdhi sot për ngushëllim.
Ah, sikur, moj të më flisje dot një fjalë,
Dhe të t'shijja dhe një herë atë ballë,
Po sa keq që në mes urë s'mund të hidhet
Që i gjalli me të vdekurin të lidhet
Zjarrin kam përbrënda, moj nga malli sot
Dhe nga breng'e ndarjes që s'durohet dot,
Krahë shpirti.³⁶... i lip vdekjes pa pushim,
Që të vij te ti, moj motër, fluturim,
Që të t'gjej në qiell të lumtur e të qetë
Në mes dritës, pranë Zotit të vërtetë.
v. 1880*

³⁶ Plotësor emëror në rasën rrjedhore. Si kryefjalë e fjalisë nënkupto: unë (shqipëruesi).

22. ZEMRA E PIKËLLUAR DHE E BRENGOSUR

*O moj zemra e zhuritur, e brengosur,
Moj e shkreta zemra ime e plagosur!
Gjer kur vallë kjo lakmi e kjo dëshirë?
Sa do vuash në rropatje e zinxhirë?
Mblidhe veten qetësohu paskëtaj!
Iki vuajtjes, pranga sipër më mos mbaj!
Dhe pse dita u bë muzg që të mërzit.
Që të mpin e që në ëndrra të vërtit,
Edhe pse bilbili heshtur kaqë shpejt
Dhe pse bota si e dehur duket krejt;
Nesër me të dalë dielli dritëshumi,
Çdo gjë prapë do të zgjohet shpejt nga gjumi.
Herë toka qesh si kopësht në pranverë,
Një kasolle brengash bota disa herë.
Këta drurë që të mplakur duken sot,
Çdo pranverë mbushen flet'e kokrra plot.
Kurse zogu i ditës³⁷ sate, moj, shkoi e ra.
S'ke ç'e do kët vërtitje të pavlerë
Që nuk bie pas të bukurës pranverë.
O moj zemër që po tretesh në mundim,
Shoqja ime, moj, në breng'e pikëllim!
Unë them se kur i Tokës Perëndi
- Krijimtari i kaq qiejve pa kufi -
Mbujti me të brengës baltë, moj, njerinë
Tej nga dera e vet e shtyti, moj, të zinë.
Prandaj në rënkim ne jemi ditë e natë
Në mundim e vaj e zi, e në krajatë.
Rrug'e keqe dhe plot dredha, ah, kjo jetë!
Fundi ynë një asgjëzë do të jetë.
O ti qiell i paturp e tradhtar,
Shpirtlëndonjës, i padrejtë, gjakatar!
Mbasi tënden Afërditë duam ne,
Te ti robër jemi bërë sot mbi dhe.
Zogu i zemrës që në zjarr e sheh çdo ças
Qan, rënkon posi bilbili në kafaz.
Dashuria për nargjizin³⁸ e atij...
Dhe llahtara e vështrimit plot magji...
Krejt e shkrehën zogn'e Tokës, kur... papritur
Që nga qiell'i kaltër Marsi si i shqitur
Ja thyen krahët, ah të mjerit, me shigjetë,³⁹
S'ka mburojë ndaj kësaj e s'do të ketë*

³⁷ Kupto: dita (d.m.th. lumturia) si zog...

³⁸ Sikurse është treguar më lart, me fjalën nargjiz (bathrë) emërohen poetikisht sytë e bukur (shqipëruesi).

³⁹ Shënojmë se Naimi këtu ndjek traditën e poezisë klasike greko-romake për planetin Mars si perëndi e luftës, e jo atë të poezisë iraniane, ku si planet me funksion pak a shumë të njëjtë me atë të Marsit vështrohet Merkuri (prej nga edhe emri i tij Tir, që do të thotë shigjetë).

*Sa Herkulë, sa Akilë, sa Rrustemë⁴⁰
Nga të Marsit shtiz'e pall... u vranë u prenë!
Ç'do përpykje, çdo rropatje, është e kotë,
Lum ai që s'e pa fare këtë botë!
v. 1883*

⁴⁰ Rrustemi ose Rrustem Zali; heroi më i dashur i eposit popullor të Iranit dhe kryekreshniku i Shahnamesë së Firdusit (shqipëruesi).

23. VASHA NAZEMADHE DHE ME TË ECUR TË KENDSHËM

*Yll i fatit mbi ty qeshur ka, moj lule,
Hiri i Zotit po të rrit ty me pekule.
S'janë sy, moj, por dy yje ata dy,
Është hënë, s'është ball'ai mbi ty.
Ajo gojës, ato faqe sy e flokë
Dritë qiejsh janë rënë te kjo tokë
Nga lulishtja e parajsës lule je,
Në fytyrn'e nuses zbritur ke mbi dhé
Kjo ëndje, ky gazmend, kjo hijeshi,
Këto naze, ky shkëlqim, këto veti;
Që nga qiejt kanë rënë, o faqedritë,
Kopsht'i mermë je nga ngjyrat dhe stolitë.
Nga fytyra që ke ti, moj meskëputur,
Skuqet, zverdhet e livadhët faqja-e bukur.
Pse je ti, asnjë burbuqe s'ka këtu,
Shkatërruar... bathra krejt nga syt'e tu.
Nga cullufi yt zymbyli krejt shpërndarë,
I penduar që s'u fsheh, moj, që më parë.
Buza jote trëndafilin⁴¹ la në turp,
Mbushur lulet plot me gjakn'e tëndit trup.
Ndër kaq lule që ka e Tokës hapësira
Je m'e mira, je m'e mira, je m'e mira!
Ti më shkon si Afërdita, nazemadhe,
Posi zana ti më bredh, moj, ndër livadhe.
Gjithë hiret që ka kupa kaltëroshe
Falur ty ti ka moj imja bukuroshe.
Yll a ëngjëll qofsh, o vashëzë Edeni.
Bukuroshe, nazemadhe të të kemi.
Nga ky shtati yt i bukur si ergjënd
Dhe nga nuri i të ecurit, moj, tënd,
Nga dy buzët luleshegës, gëzimplote,
Dhe nga faqet, dhe nga supat, qafa jote,
Si edhe nga ngjyrat, lulet farë-farë
Dhe nga zogjtë kokrrambledhës, këngëtarë;
Plot me gaz m'u mbush kjo zemra e mjerë
U ndërtua dhe u çel posi pranverë.
Ky vështrim, moj, dhe kjo jotja bukuri
Kjo fytyrë që tregon, moj, kaq çudi.
Ecja, nazet, kjo nënqeshje dhe kjo pamje,
Që të josh e që në shpirt s'të lë ofshamje,
Kopshti, kroi dhe pranvera me stolitë,
Qielli mbushur me të fshehta dhe me dritë,
Këta zogj vjershëkëndonjës, kjo pyllishte
Këto suka dhe këjo trëndafilishte.⁴²*

⁴¹ Vargje të një bukurie të madhe ku fjalët bathra (nargjiz), zymbyli dhe trëndafil janë vënë përkatësisht pranë fjalëve: sy, cullufe e buzë, simbole të të cilave ato janë. Është për t'u habitur me shkathtësinë e sigurinë që tregoi Naimi në ndërtimin e vargut persisht (shqiperuesi).

*Gaz m'i falën shpirtit tim q'u mbyl lotë,
Por ç'e do se gaz përjetë s'ka në botë.⁴³
Se asgjë nuk ka këtu përjetësi;
Mëngjes, verë, bukuri e djalëri:
Si i kroit ujët shkojnë pa pushim
Asnjë gjë nuk rron përjetë, ah, ç'mjerim!
v. 1873*

⁴² Mundet që me fjalën trëndafilishte poeti të ketë për qëllim bijën e vet të bukur së cilës ai i këndon e që duhet të jetë, mendojmë, jo bija e tij e adoptuar, por ajo të cilën ai e qan (vjersha nr. 19). Pra kjo vjershë, edhe pse mban nr. 23 është më e vjetër). Edhe pse mundemi t'i grupojmë vjershat e kësaj përmbledhjeje poetike, nga përmbajtja e tyre nuk jemi në gjendje të caktojmë mirë kriterin që ka ndjekur, as kriterin kronologjik, e as atë përmbajtësor (shqipëruesi).

⁴³ Duket se poeti parandjen vdekjen e hershme të së bijës, bukurinë e të cilës e këndoi me aq zjarr (shqipëruesi).

24. NË VDEKJE TË VËLLAIT

*Tashti ngjyrat që ka toka s'kam ç'i dua.
Pas kësaj kuptim më s'kanë, ah, për mua;
Jon i Kroit, këngë e zogjve aq gazmore
Drita, lulet dhe stolitë pranverore
Zemra ime më mësoi të di në jetë
Vaj-rënkimn' e rrebeshparësve të shkretë.
Zemra ime që rënkon nuk gjen tashti
Se u zhyt, u shkri në brengë e në zi
S'gjen tashti në këtë botë asnjë shije.
Iku, iku mjeri unë u bë hije
Qok e zemrës, prehje e zemrës,
Në mes resë së mjerimit mbeta sot.
I pashpresë jam tashti e dhëmbjeplot.
Ku e ke o qiell vallë drejtësinë?
Ku e ke mëshirën, hirin, bujarinë?
Trëndafil-zymbuli që i desh ay
Sot nga balt'e tij shpërthejnë që të dy.
Bimët që ai nën këmb' i kishte dje
Shih si dalin sot-o nga i tiji dhé.⁴⁴*

⁴⁴ Të vjen sikur po dëgjon Saadinë (shqipëruesi).

Boton:
Shtëpia botuese RUMI - Tetovë
Përpunimi grafik dhe shtypi Focus - Shkup
Botimi i parë

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës:
Hysni ISMAILI

Tekstet e prezentuara domosdoshmërisht nuk përfaqësojnë politikën e redaksisë të Dielli.net!
dielli@dielli.net